



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 15718/1 Pro

Tiranë, 04.07.2017

DEPARTAMENTIT TEKNIK  
DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV  
DEPARTAMENTIT OPERATIV HETIMOR  
GJITHË DEGËVE DOGANORE

**Lënda: Dërgim udhëzimi për zbatim.**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për zbatim Udhëzimin numër 05, date 04.07.2017 "Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Lejimit të Përkohshëm për mallrat e mbuluara me Carnet ATA".

Të merren të gjitha masat për zbatim.

Mirela MEKO

ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 16718 Prot

Tiranë, 04-07 2017

UDHËZIM

Nr. 06, datë 04-07 2017

MBI

ZBATIMIN PRAKTIK TË REGJIMIT TË LEJIMIT TË PËRKOHSHËM TË MALLRAVE  
TË MBULUARA ME CARNET ATA

Në kuadër të standartizimit dhe thjeshtimit të procedurave doganore, lidhur me importin dhe eksportin e mallrave nën regjimin e lejimit të përkohshëm dhe të mbuluar nga Carnet ATA;

Bazuar në;

- Ligjin nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë",
- Ligjin nr.10077, datë 16.02.2009 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Lejimin e Përkohshëm, bërë në Stamboll me 26 Qershor 1990";
- Memorandumin e bashkëpunimit "Për autorizimin e lëshimit të dokumentit doganor ndërkombëtar Carnet ATA dhe mbi zbatimin e dispozitave të Konventës për Lejimin e Përkohshëm, bërë në Stamboll me 26 Qershor 1990" të nënshkruar me Bashkimin e Dhomave të Trgtisë dhe Industrisë të Shqipërisë (U.C.C.I.AL) me nr.310 Prot., datë 10.01.2013 (nr.652 Prot., datë 18.12.2012);
- Në mbështetje të pikës 1(b)(i), të Pjesës VIII/1, të VKM Nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për personelin e Administratës Doganore", të ndryshuar;

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;

UDHËZON:

1.Përkufizime:

Për qëllime të këtij udhëzimi:

- 1.1. "Carnet ATA" - është dokument doganor ndërkombëtar që, pranohet si deklaratë doganore në të gjithë vëndet antare të Konventës së Stambollit mbi lejimin e përkohshëm, duke bërë të mundur identifikimin e mallrave dhe garantimin e çdo borxhi të mundshëm me një garanci të vlefshme ndërkombëtarisht për të mbuluar të gjitha detyrimet dhe taksat e importit.
- 1.2. "Konventa e Stambollit" - është Konventa mbi lejimin e përkohshëm, e nënshkruar në Stamboll më 26 qershor 1990, e miratuar me ligjin nr.10077, datë 16.02.2009 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Lejimin e Përkohshëm, bërë në Stamboll me 26 Qershor 1990";

- 1.3. Carnet ATA lëshohet nga një palë kontraktuese e Konventës së Stambollit dhe është miratuar dhe garantuar nga një shoqëri (zakonisht, këto janë Dhomat Kombëtare të Tregtisë), e cila është pjesë e një zinxhiri garantues siç përcaktohet në nenin 1 (d) të Shtojcës A të Konventës së Stambollit;
- 1.4. Në Shqipëri dokumenti Carnet ATA që shoqëron mallrat shqiptare të cilat eksportohen përkohësisht lëshohet nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë (U.C.C.I.A.L) që është njëkohësisht dhe garantues (pjesë e zinxhirit garantues) dokument që plotësohet dhe e çertifikon autoriteti doganor në zyrës doganore të eksportit (daljes) të mallrave.

## 2. Përmbajtja dhe mënyra e përdorimit të Carnet ATA

- 2.1 Carnet ATA është i përbërë nga disa fletë me ngjyra të ndryshme. Fleta e parë, me ngjyrë jeshile, përmban informacion mbi:
- lëshuesin e këtij dokumenti,
  - numrin identifikues të Carnet-it,
  - vlefshmërinë,
  - vendet pjesëmarrës në konventë të cilat njohin këtë dokument,
  - listën e mallrave që do të lëvizin nën këtë dokument, si dhe;
  - miratimin me firmë dhe vulë nga autoriteti lëshues si dhe autoriteti doganor.
- 2.2 Gjithashtu, pjesë e këtij dokumenti janë fletët dhe kundrafletët, ngjyra e të cilave është e ndryshme në varësi të përdorimit të tyre; tipit të procedurës dhe vëndit të përdorimit, konkretisht:
- 2.2.1 *Fletët me ngjyrë të verdhë (voucher)* përdoren kur territori shqiptar është vend eksportues i mallrave. Keto fletë përmbajnë të gjithë të dhënat që lidhen me mallrat dhe kryen funksionin e një deklarate doganore eksporti (në dalje) ose ri-importi (në hyrje të territorit doganor).

*Në rastet e eksportit të mallrave të mbuluara me Carnet ATA (si deklarate eksporti), zyra doganore e eksportit kryen formalitetet si më poshtë:*

- Verifikojnë informacionin e dhënë në kutinë A deri në G të fletës së eksportit
- Plotësojnë sipas nevojës kutinë “Çertifikuar nga autoritetet doganore” në faqen e parë të Carnet-it
- Plotësojnë kundër-fletën dhe kutinë H të fletës së eksportit
- Identifikojnë zyrën doganore të eksportit në kutinë H (b) të fletës së ri-importit
- Mbajnë fletën e eksportit
- Regjistrojnë të dhënat në regjistrin për Carnet ATA.

Kur zyra doganore e eksportit nuk është zyrë doganore e daljes, ajo kryen formalitetet e sipërpërmendura, por nuk plotëson kutinë 7 të kundër-fletës, e cila plotësohet në zyrën doganore të daljes.

Afatet kohore për ri-importimin e mallrave të përcaktuara nga zyra doganore e eksportit në kutinë (b) të fletës së eksportit nuk mund të kalojnë vlefshmërinë e Carnet-it.

*Në rastet e ri-importit të mallrave të mbuluara me Carnet ATA autoritetet doganore do të kryejnë veprimet:*

- verifikojnë informacionin e dhënë në kutinë A deri në G të fletës së ri-importit.
- plotësojnë kundër-fletën dhe kutinë H të fletës së ri-importit

- mbajnë fletën e ri-importit dhe pjesën e kundrafletës
- regjistrojnë të dhënat në regjistrin e Carnet-eve ATA.

2.2.2 *Fletët me ngjyrë të bardhë* (voucher) përdoren kur territori shqiptar është vend importues i mallrave. Keto fletë përmbajnë të gjithë të dhënat mbi mallrat, (si një deklaratë doganore importi të përkohshëm).

*Në rastet e importit të mallrave të mbuluara me Carnet ATA* (si deklaratë importi të përkohshëm), autoritetet e zyrës doganore të hyrjes kryejnë formalitetet si më poshtë:

- verifikojnë informacionin e dhënë në kutitë nga A deri në G të fletës së importimit;
- plotësojnë kundrafletën dhe kutinë H të fletës së importimit; [data përfundimtare për rieksporimin e mallrave që shënohet në kutinë H (b), nuk duhet të jetë me vone se data në të cilën skadon afati i Carnetit];
- plotësojnë emrin dhe adresën e zyrës së vendosjes nën regjim në kutinë H (e) të fletës së rieksporimit;
- mbajnë fletën e importimit.
- informohet nga mbajtësi i Carnet-it se ku do të dalin mallrat (ri-eksportohen) dhe njekohesisht e informon atë për domosdoshmerinë e paraqitjes pranë autoriteteve doganore të mallrave dhe Carnetit ATA në momentin e daljes nga territori.
- regjistrojnë të dhënat në regjistrin për Carnet ATA.

*Në rastet e rieksporimit të mallrave të mbuluara me Carnet ATA* (si deklaratë importi të përkohshëm), autoritetet e zyrës doganore të daljes kryejnë formalitetet si më poshtë:

- verifikojnë informacionin e dhënë në kutinë A deri në G të fletës së ri-eksportit të mallrave nën mbulimin e Carnet-it
- plotësojnë kundër-fletën dhe kutinë H të fletës të ri-eksportit
- mbajnë fletën e ri-eksportit dhe pjesën e kundrafletës
- regjistrojnë të dhënat në regjistrin për Carnet ATA.

2.2.3 *Fletët me ngjyrë të kaltër* (voucher) përdoren kur territori shqiptar është vend transit i mallrave. Edhe fletët me ngjyrë të kaltër përmbajnë të gjithë të dhënat mbi mallrat, (si një deklaratë doganore transit). Autoritetet doganore të zyrës hyrëse dhe dalese, kryejnë formalitetet e përshkruara më poshtë:

- verifikojnë informacionin e dhënë në kutinë A deri në G të fletës së kaltër;
- plotësojnë kundër-fletën dhe kutinë H të fletës transit;
- mbajnë fletën transit dhe pjesën e kundrafletës (doganën dalëse).

2.3. Carnet ATA do të njihet vetëm për mallrat e lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë sipas shtojcave B1-B9, D si dhe shtojcës C të Konventës së Stambollit (Ligji nr. 10077, datë 16.02.2009), si vijon:

- a) lejimi i përkohshëm lidhur me mallrat për t'u shfaqur ose përdorur në ekspozita, panaire, mbledhje ose ngjarje të ngjashme (Shtojca B.1);
- b) lejimi i përkohshëm lidhur me pajisjet profesionale (Shtojca B.2)
- c) lejimi i përkohshëm për kontenjerët, paletat, ambalazhet, mostrat dhe mallra të tjera të importuara në lidhje me një operacion tregtar (Shtojca B.3);
- ç) lejimi i përkohshëm për mallrat e importuara në lidhje me një operacion përpunimi (Shtojca B.4);

- d) lejimi i përkohshëm për mallrat e importuara për qëllime edukative, shkencore dhe kulturore (Shtojca B.5);
- dh) lejimi i përkohshëm për sendet personale të udhëtarit dhe mallrat e importuara për qëllime sportive (Shtojca B.6);
- e) lejimi i përkohshëm për materialet promociionale turistike (Shtojca B.7);
- ë) lejimi i përkohshëm për mallrat e importuara si transport kufitar (Shtojca B.8);
- f) lejimi i përkohshëm për mallrate importuara për qëllime humanitare (Shtojca B.9);
- g) lejimi i përkohshëm i pjesët e këmbimit dhe pajisjet e importuara për riparimin e mjeteve të transportit, të cilat janë lejuar përkohësisht (Shtojca C, neni 2/b);
- gj) lejimi i përkohshëm për kafshët (Shtojca D)

2.4 Carnet ATA nuk do të njihet nga autoritetet doganore (pra, nuk do të zëvendësojë autorizimin e regjimit të lejimit të përkohshëm dhe as deklaratën doganore) në rastet kur autoritetet doganore konstatojnë se:

- Mallrat për të cilat është lëshuar Carnet ATA i përkasin shtojcës E – “mallra të importuara me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe taksave”. (Kjo pasi këto mallra nuk janë pjesë e memorandumit me U.C.C.I.A.L).
- Dokumenti Carnet ATA nuk është plotësuar dhe çertifikuar nga autoritetet doganore të vendit ku është lëshuar.
- Në rastet kur vërehen parregullsi në plotësimin e të dhënave të Carnet ATA apo kur këto të dhëna nuk përputhen me mallrat.

Për të gjitha rastet e sipërpërmendura duhet të zbatohen formalitetet e vendosjes së mallrave nën regjimin e Lejimit të Përkohshëm kundrejt pajisjes me autorizim (në rastet e RLP me përjashtim të pjesshëm) dhe depozitimit të deklarates doganore për regjimin në fjalë.

### **3. Mbikqyrja e regjimit të lejimit të përkohshëm të mallrave nën Carnet ATA:**

3.1. Kontrolli i regjimit nën Carnet ATA do të kryhet nga zyrat doganore ku janë kryer formalitete doganore të hyrjes, daljes dhe/ose transistit. Të gjitha degët doganore do të mbajnë një regjistër ku do të shënohen të dhënat mbi Carnet-et e hyra/dala në/nga territori doganor shqiptar. Ky regjistër mund të mbahet në format excel ose çdo formë tjetër të ndryshme, por të përmbajë detyrimisht të dhënat sipas *Aneksit 1 bashkëlidhur, pjesë e këtij udhëzimi.*

3.2. Zyra doganore që përmbyll një regjim të Lejimit të përkohshëm për mallra të mbulurara nga një Carnet ATA (zyra dalëse) duhet të njoftojë zyrtarisht zyrën, nëpërmjet të cilës mallrat kanë hyrë nën regjim (zyrën hyrëse) duke i dërguar bashkëngjitur një kopje të kuponit të ri-eksportimit si dhe kundra-fletës.

3.3. Degët doganore çdo datë 5 të muajit do të bëjnë rakordimet për të evidentuar të gjitha rastet kur Carnet-et ATA rezultojnë të pambyllura sipas të dhënave që përmban regjistri sipas pikës 3.1. të këtij udhëzimi.

3.4. Në të gjitha rastet kur zyra nëpërmjet të cilës mallrat kanë hyrë nën regjim (zyrën hyrëse) arrin në konkluzionin se regjimi nuk është mbyllur, njofton menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Gjithashtu, bazuar në të dhënat e Carnet-it ATA dhe dokumentacionit shoqëruar të mallrave, zyra hyrëse përlogarit edhe detyrimin doganor për t'u paguar apo shumën e borxhit doganor të lindur nga mosrespektimi i kushteve të regjimit në fjalë.

3.5. Për çdo rast të mospërbushjes së një nga detyrimet sipas Carnet ATA për të cilin ka lindur borxhi doganor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i kërkon U.C.C.I.AL që, garanton lëvizjen e këtyre mallrave nën Carnet ATA, pagesën e shumës së borxhit të konstatuar. Kërkesa për pagesën e shumës së borxhit doganor si dhe llogaritja e detyrimit doganor, drejtuar U.C.C.I.AL duhet të jetë sipas *Aneksit 2 bashkelidhur, pjesë e këtij udhëzimi.*

3.6. U.C.C.I.AL, brenda një periudhe prej 6 muajve, duhet të paraqesë prova mbi rieksporimin apo mënyra të tjera shkarkimi të Carnet-it ATA, sipas përcaktimeve në pikën 1 të nenit 9 të Shtojcës A të Konventës për Lejimin e Përkohshëm. Në rast se, keto prova, nuk janë paraqitur brenda periudhës së caktuar kohore, U.C.C.I.AL është i detyruar të bëjë depozitën ose pagesën e përkohshme të shumës së kërkuar. Depozitat ose pagesat e përkohshme do të konsiderohen si përfundimtare pas skadimit të periudhës 3 mujore që nga data e kryerjes së depozitës apo pagesës. Brenda periudhës kohore të lartpërmendur, U.C.C.I.AL ende mund të paraqesë fakte dhe evidenca me qëllim që të arrihet rikthimi i shumave të paguara apo depozituara.

3.7. Fleta e ri-eksportimit e Carnet-it, e plotësuar dhe vulosur nga autoritetet doganore, konsiderohet si provë për ri-eksportimin e mallrave të lejuara përkohësisht nën Carnet-in ATA.

3.9. Nëse ri-eksportimi nuk është provuar në përputhje me pikën 3.6 edhe pse periudha e vlefshmërisë së Carnet ATA mund të ketë përfunduar, autoritetet doganore mund të pranojnë si provë të ri-eksportimit dokumentat e mëposhtme:

- a) të dhënat e veçanta të regjistruara në organet doganore ose në ndonjë prej palëve të tjera kontraktuese në dokumentet e lejit të përkohshëm mbi importimin ose rieksporimin,
- b) me anë të një certifikate të lëshuar nga këto organe të mbështetur në të dhënat e veçanta të paraqitura në fletën e shkëputur nga dokumentet e importimit dhe ri-importimit e cila provohet të ketë ndodhur pas ri-eksportimit të kryer,
- c) çdo provë tjetër dokumentare nëpërmjet të cilës të vertetohet se mallrat e lejuara përkohësisht janë rieksportuar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

#### 4. Carnet ATA zëvendësues:

4.1 Kur parashikohet që operacionet e lejit të përkohshëm mund të tejkalojnë periudhën e vlefshmërisë së Carnet-it ATA për shkak se mbajtësi nuk është në gjendje të rieksportojë mallrat, shoqata që lëshon Carnet-in mund të lëshojë një Carnet Zëvendësues. Mbajtësi duhet t'ia kthejë Carnet-in origjinal shoqatës që e lëshoi atë.

4.2 Carnet-i zëvendësues depozitohet pranë zyrës doganore kompetente për vendin ku ndodhen mallrat, e cila kryen formalitetet e mëposhtme:

- mbyll Carnet-in fillestar duke përdorur fletën e ri-eksportimit të cilën duhet ta kthejë pa vonesë në zyrën doganore fillestare për lejimin e përkohshëm;

- marr Carnet-in zëvendësues dhe mban fletën e importimit, së pari duke shënuar në këtë fletë datën e fundit për ri-eksportimin siç tregohet në Carnet-in fillestar, duke shtuar zgjatjen e afatit dhe numrin e Carnet-it origjinal.

Kur mbyllet regjimi i lejit të përkohshëm, autoritetet e zyrës doganore të daljes (zyra e ri-eksportimit) kryejnë formalitetet si më poshtë:

- plotësojnë kundër-fletën dhe kutinë H të fletës së ri-eksportimit;
- mbajnë fletën e ri-eksportimit dhe pa vonesë ia kthejnë zyrës doganore të referuar në kutinë H

(e), duke përdorur fletën e Carnetit zëvendësues, e cila i kthehet pa vonesë zyrës doganore që pranon Carnetin zëvendësues.

4.3 Lëshimi i një Carneti zëvendësues është përgjegjësi e shoqatës që e lëshon. Nëse Carneti ATA skadon dhe mbajtësi i regjimit nuk është në gjendje të rieksportojë mallrat si dhe shoqata që lëshoi Carnetin refuzon të lëshojë një Carnet zëvendësues, autoritetet doganore kërkojnë plotësimin e një kërkesë të re:

- për importimin e përkohshëm (me perjashtim të plote nga detyrimet e importit) ose,
- për përcaktimin e një destinacioni tjetër doganor të përshtatshëm për mallrat në fjalë.

5. Deri në implementimin e modulit të Carnet-it ATA në sistemin kompjuterik doganor, deklarimi për mallrat që shoqërohen me këtë dokument do të kryhet nepermjet depozitimit të dokumentit origjinal të Carnet ATA dhe kryerjes së formaliteteve të pershkruara në pikën 1 të këtij udhëzimi, pa qene nevoja e pajisjes me autorizim dhe përpilimit të deklarates doganore (DAV) për regjimin e lejimit të përkohshëm me perjashtim të plote.

6. Në të gjitha rastet kur mallrat që hyjnë/dalin në/nga territori doganor shqiptar të shoqëruara me dokumentin Carnet ATA, procedurat e vendosjes së tyre nën regjimin e lejimit të përkohshëm ose ri-iptimit të mallrave të eksportuara përkohsisht, do kryhen në zyrat doganore kufitare. Lidhur me verifikimin doganor të mallrave, autoritete doganore kompetente duhet të kryejnë një analizë risku lokale për këto mallra në përputhje me udhëzimin për analizën e riskut.

7. Ngarkohen Zyrat Doganore Kufitare, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Procedurave Doganore për zbatimin me korrektesë të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**Belinda IKONOMI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**





## ANEKSI 2

### Formulari i kërkesës për pagesë drejtuar shoqatës garantuese të borxhit për llogaritjen e detyrimit doganor që rezulton nga regjimi i Lejimit të Përkohshëm nën Carnet ATA

Dt.....Nr.....

Të dhënat në vijim duhet të jepen sipas rendit të mëposhtëm:

Nr.i Carnet ATA	
Nr.i kuponit (voucher) të transitit/importit	
Data e nënshkrimit të kuponit (voucher)	
Mbajtësi i regjimit dhe adresa	
Bashkimi i Dhomave të Tregëtisë dhe Industrisë së Shqipërisë	
Vendi i origjinës	
Data e skadimit të Carnet-it	
Data e caktuar për riekportimin e mallrave	
Zyra doganore e hyrjes	
Zyra doganore e lejimit të përkohshëm	
Përshkrimi tregtar i mallrave	
Kodi i NK	
Numri i copëve	
Pesha ose volumi	
Vlera	

Ndarja e taksave dhe detyrimit :

Tipi Baza e taksës	Niveli	Shuma e detyrimit	Kursi i këmbimit	
Totali				
<i>(Totali me fjalë):</i>				

17. Zyra doganore:

Vendi dhe data:

Nënshkrimi: Vula